

GRATË POLITIKANE NË HAPËSIRËN DIGJITALE: ANALIZA E KATËRT E DISKURSIT ONLINE NË KOSOVË

(Maj – Korrik 2026)



GRATË POLITIKANE NË HAPËSIRËN DIGJITALE: ANALIZA E KATËRT E DISKURSIT ONLINE NË KOSOVË

(Maj – Korrik 2026)

Prishtinë, gusht 2026

Përgatitur nga: Instituti Demokraci për Zhvillim (D4D)

Të drejtat e autorit ©2026. Instituti Demokraci për Zhvillim (D4D).

Të gjitha të drejtat e rezervuara. Përveç citimeve të shkurtra për qëllime kritike dhe rishikimi, asnjë pjesë e kësaj publikimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet në çfarëdo sistemi të rikthimit të të dhënave, apo të transmetohet në çfarëdo forme apo përmes çfarëdo mjeti, qoftë elektronik, fotokopjues, regjistruar apo tjetër, pa lejen paraprake të D4D.

Ky raport u përgatit në kuadër të projektit “Mbështetje për Shoqërinë Civile në Kosovë”, i financuar nga Dukati i Madh i Luksemburgut dhe i implementuar nga LuxDev, Agjencia e Luksemburgut për Bashkëpunim Zhvillimor.

Qëndrimet e shprehura në këtë publikim janë të autorëve dhe nuk pasqyrojnë patjetër pikëpamjet e Dukatit të Madh të Luksemburgut apo të individëve.

Tabela e përmbajtjes

Hyrje	3
Metodologjia	5
Ecuria mujor e raportimit dhe reagimeve në hapësirën digjitale	6
Komentet me gjuhë të urrejtjes ndaj grave në politikë ...	6
Aktiviteti mediatike dhe ndërveprimi i publikut gjatë muajit maj.....	8
Aktiviteti mediatike dhe ndërveprimi i publikut gjatë muajit qershor	9
Aktiviteti mediatike dhe ndërveprimi i publikut gjatë muajit korrik	10
Rastet e dezinformimit dhe sulmeve me bazë gjinore ndaj grave politike	12
Përmbajtjet e pavërteta dhe sensacionaliste për Vjosa Osmani-Sadriun	12
Rekomandime	16



Hyrje

Hapësira digjitale është shndërruar në një nga arenat kryesore të komunikimit politik dhe të formësimit të opinionit publik në Kosovë. Mediat online dhe rrjetet sociale u mundësojnë qytetarëve qasje të shpejtë në informacion dhe ndërveprim të drejtpërdrejtë me përfaqësuesit politikë. Megjithatë, këto platforma përdoren gjithnjë e më shumë edhe për përhapjen e dezinformimit, gjuhës së urrejtjes dhe sulmeve personale, të cilat prekin në mënyrë të veçantë gratë e angazhuara në jetën politike.

Gratë politike përballen jo vetëm me kritikë ndaj qëndrimeve dhe veprimtarisë së tyre publike, por edhe me sulme që synojnë gjininë, pamjen, moralin, familjen dhe jetën e tyre private. Në shumë raste, debati përmbajtësor zëvendësohet nga etiketime denigruese, insinuata, stereotipe patriarkale dhe narrativa të pavërteta. Këto forma të dhunës digjitale cenojnë autoritetin dhe kredibilitetin e grave, duke e bërë pjesëmarrjen e tyre në jetën publike më të vështirë dhe më të pasigurt.

Ky është raporti i katërt periodik që Demokraci për Zhvillim (D4D) publikon në kuadër të monitorimit të trajtimit të grave politike në hapësirën digjitale. Përmes kësaj serie raportesh, D4D synon të evidentojë në mënyrë të vazhdueshme tendencat, narrativat dhe format e sulmeve digjitale ndaj grave në politikë, si dhe ndryshimet e tyre në periudha të ndryshme të zhvillimeve politike.

Raporti analizon mënyrën se si gratë politike në Kosovë janë përfaqësuar, diskutuar dhe trajtuar në mediat online dhe në rrjetet sociale gjatë periudhës maj–korrik 2026. Periudha e monitorimit përfshin fushatën, zgjedhjet e 7 qershorit dhe zhvillimet paszgjedhore, të cilat prodhuan një intensitet të lartë raportimi, ndërveprimi dhe diskutimi publik. Kjo e bën periudhën veçanërisht të rëndësishme për të kuptuar se si rritja e vëmendjes politike ndikon në ekspozimin e grave ndaj sulmeve dhe përmbajtjeve manipuluese.

Përmes ndërthurjes së analizës sasiore dhe cilësore, raporti shqyrton vëllimin dhe dinamikën e raportimit mediatic, ndërveprimet e publikut dhe praninë e gjuhës së urrejtjes në komentet online. Në total, janë analizuar 150,103 komente, prej të cilave 13,320, ose 9%, janë klasifikuar si gjuhë e urrejtjes. Raporti trajton gjithashtu raste konkrete të përmbajtjeve të pavërteta, sensacionaliste dhe me bazë gjinore ndaj grave politike, duke evidentuar narrativat dhe teknikat e përdorura për delegitimimin e tyre.

Qëllimi i raportit është të kontribuojë në kuptimin më të mirë të rreziqeve me të cilat përballen gratë në hapësirën digjitale dhe të nxisë përgjegjësi më të

madhe nga mediat, partitë politike, institucionet publike dhe platformat teknologjike. Mbrojtja e grave nga dezinformimi dhe dhuna digjitale nuk lidhet vetëm me sigurinë dhe dinjitetin individual, por edhe me cilësinë e debatit demokratik dhe garantimin e pjesëmarrjes së barabartë në politikë.



Metodologjia

Ky raport paraqet rezultatet e monitorimit të pranisë, perceptimit dhe trajtimit të grave politikane në hapësirën digjitale gjatë periudhës maj - korrik 2026. Monitorimi është realizuar përmes platformës së inteligjencës mediatike dhe analizës së të dhënave PIKASA, e cila mundëson mbledhjen, klasifikimin dhe analizimin e përmbajtjeve nga media online dhe rrjetet sociale.

Monitorimi është fokusuar në profilet publike të grave politikane në Kosovë, duke përfshirë bartëse të funksioneve ekzekutive, legjislativë dhe partiake. Për secilën figurë të monitoruar janë analizuar përmendjet në media online, postimet në rrjetet sociale, komentet e publikut dhe ndërveprimet e krijuara rreth tyre.

Të dhënat janë mbledhur në baza ditore gjatë gjithë periudhës së monitorimit dhe janë analizuar sipas indikatorëve kryesorë, si:

- ♦ *Numri i përmendjeve dhe raportimeve mediatike;*
- ♦ *Numri i postimeve dhe diskutimeve në rrjetet sociale;*
- ♦ *Niveli i ndërveprimit të publikut (komente, reagime dhe shpërndarje);*
- ♦ *Prania e gjuhës së urrejtjes, sulmeve gjinore dhe përmbajtjeve denigruese;*
- ♦ *Temat dhe ngjarjet kryesore që kanë gjeneruar vëmendje publike;*
- ♦ *Tendencat mujore dhe periudhat me intensitet më të lartë të diskutimit.*

Platforma PIKASA ka përdorur algoritme të analizës së tekstit për të identifikuar përmbajtje potencialisht fyese, seksiste ose të bazuara në gjini. Megjithatë, duke pasur parasysh kufizimet e analizës automatike, rezultatet janë verifikuar përmes shqyrtimit manual të rasteve më relevante, me qëllim të rritjes së saktësisë së klasifikimit.

Përveç analizës sasiore, raporti përfshin edhe një komponent cilësor, përmes së cilit janë shqyrtuar raste specifike të raportimit mediatik dhe diskutimeve online që kanë nxitur reagime të konsiderueshme publike. Kjo qasje ka mundësuar identifikimin e modeleve të komunikimit, narrativave dominuese dhe formave të sulmeve që prekin gratë në politikë.

Analiza mujore është ndërtuar mbi krahasimin ndërmjet vëllimit të raportimit mediatik dhe nivelit të angazhimit të publikut në rrjetet sociale, duke mundësuar identifikimin e ngjarjeve që kanë gjeneruar vëmendjen më të madhe publike gjatë vitit. Në këtë mënyrë, raporti ofron një pasqyrë gjithëpërfshirëse të mënyrës se si gratë politikane përfaqësohen, diskutohen dhe trajtohen në ekosistemin mediatik dhe digjital në Kosovë.

Ecuria mujor e raportimit dhe reagimeve në hapësirën digjitale

Komentet me gjuhë të urrejtjes ndaj grave në politikë

Të dhënat për periudhën maj–korrik tregojnë se, nga 150,103 komente të analizuar në mediat online dhe në rrjetet sociale, 13,320 komente, ose 9% e totalit, janë klasifikuar si gjuhë e urrejtjes. Megjithatë, përqindja është dukshëm më e lartë në komentet që lidhen me disa gra politike.

Figura 1: Ekspozimi i grave politike ndaj komenteve dhe gjuhës së urrejtjes në rrjetet sociale (Maj - Korrik 2026)



Vlora Çitaku shënon përqindjen më të lartë të komenteve me gjuhë të urrejtjes, me 19%, e ndjekur nga Blerta Deliu-Kodra me 17% dhe Fitore Pacolli-Dalipi me 15%. Në terma absolutë, Fitore Pacolli-Dalipi ka numrin më të lartë në këtë grup, me 2,226 komente me gjuhë të urrejtjes nga gjithsej 15,209 komente të analizuar. Ariana Musliu-Shoshi, Ganimete Musliu dhe Arbëreshë Kryeziu-Hyseni regjistrojnë nga 14%. Këto të dhëna tregojnë se komentet ndaj këtyre politikanëve përmbajnë gjuhë të urrejtjes në një shkallë dukshëm më të lartë se mesatarja e përgjithshme prej 9%.

Nga këndvështrimi i dezinformimit dhe dhunës digjitale me bazë gjinore, ky targetim joproporcional tregon se gjuha armiqësore dhe denigruese përdoret për të cenuar autoritetin, profesionalizmin dhe figurën publike të grave në politikë. Përveç kritikave që lidhen me qëndrimet dhe veprimtarinë e tyre politike, gratë përballen edhe me sulme që synojnë identitetin, dinjitetin dhe jetën e tyre personale.

Analiza cilësore e komenteve tregon se diskutimi shpesh zhvendoset nga kritika politike ose debati përmbajtësor drejt sulmeve personale, fyese dhe dehumanizuese.

Kjo gjuhë shfaqet përmes etiketimeve poshtëruese, fyerjeve ndaj inteligjencës dhe aftësive profesionale, referencave denigruese ndaj prejardhjes ose historive familjare, si dhe akuzave kriminalizuese apo fyerjeve me bazë etnike.

Në raste të tjera, retorika përshkallëzohet në gjuhë vulgare me përmbajtje seksuale dhe në fyerje të drejtuara ndaj familjarëve. Kjo dëshmon se gratë në politikë përballen me një formë të dyfishtë presioni: kundërshtimit politik i shtohen sulmet ndaj moralit, pamjes dhe dinjitetit të tyre personal. Si pasojë, hapësira për pjesëmarrjen e tyre në debatin publik ngushtohet dhe mund të krijohet një efekt frenues (*chilling effect*), i cili dekurajon gratë e tjera nga angazhimi politik dhe përfshirja në vendimmarrje.


Dukuria nuk kufizohet vetëm në publikimet mediatike kushtuar politikaneve, por është e pranishme edhe në komentet e publikuara drejtpërdrejt në postimet e tyre. Për shembull, nga 8,737 komente në postimet e Ganimete Musliut, 1,134, ose rreth 13%, janë klasifikuar si gjuhë e urrejtjes. Kur përfshihen të gjitha publikimet e monitoruara që lidhen me të, numri arrin në 1,372 komente me gjuhë të urrejtjes nga gjithsej 9,562 komente, përkatësisht 14%.

Në tërësi, të dhënat tregojnë se hapësirat digjitale nuk shërbejnë vetëm si platforma për debat politik, por edhe si mjedise ku riprodhohen dhe përforcohen stereotipet gjinore dhe sulmet ndaj grave në jetën publike. Prandaj, monitorimi sistematik, moderimi më efektiv i përmbajtjes dhe reagimi institucional janë të nevojshëm për të mbrojtur pjesëmarrjen e barabartë dhe të sigurt të grave në politikë.

Aktiviteti mediatike dhe ndërveprimi i publikut gjatë muajit maj

Gjatë majit 2026, aktiviteti mediatik dhe ndërveprimi i publikut shfaqën luhatje të konsiderueshme, në kontekstin e afërimit të zgjedhjeve të 7 qershorit. Numri i artikujve u rrit ndjeshëm në pjesën e parë të muajit, duke arritur pikën më të lartë më 9 maj, me 513 artikuj. Nivele të larta publikimi u regjistruan edhe rreth datave 5, 13–15 dhe 20 maj, me afërsisht 400–500 artikuj në ditë.

Figura 2. Dinamika e artikujve, postimeve dhe ndërveprimeve publike gjatë muajit maj 2026



Ndërveprimet e audiencës ndoqën një dinamikë më të luhatshme dhe nuk përkonin gjithmonë në kohë me vëllimin e publikimeve. Kulmet kryesore u regjistruan rreth 10 dhe 14 majit, kur numri i ndërveprimeve iu afrua ose tejkaloi 22,000. Kjo sugjeron se disa zhvillime politike gjeneruan interes të lartë edhe pas publikimit fillestar të lajmeve. Megjithatë, vetëm nga grafiku nuk mund të përcaktohet nëse rritja e ndërveprimeve u shkaktua drejtpërdrejt nga numri i artikujve apo nga përmbajtja dhe rëndësia politike e temave të trajtuara.

Në gjysmën e dytë të muajit, vëllimi i artikujve ra krahasuar me periudhën e parë, por u shënuan rritje të veçuara rreth 20–21 majit dhe në fund të muajit. Edhe ndërveprimet shfaqën kulme të dallueshme rreth 21, 25 dhe 29 majit, ndonëse numri i artikujve në disa prej këtyre ditëve ishte relativisht më i ulët. Kjo tregon se një numër më i vogël publikimesh mund të ketë gjeneruar reagim të madh kur përmbajtja lidhej me zhvillime me interes të lartë publik.


Postimet e drejtpërdrejta në rrjetet sociale mbetën dukshëm më të pakta se artikujt, përgjithësisht nën 100 postime në ditë. Ato shënuan rritje të moderuara rreth datave 5, 15, 22 dhe 31 maj. Opinionet dhe shkrimet autoriale përbënin një pjesë minimale të përmbajtjes së monitoruar dhe nuk patën ndikim të dukshëm në dinamikën e përgjithshme.

Në tërësi, grafiku pasqyron një mjedis informativ intensiv, por jo të qëndrueshëm, të karakterizuar nga valë publikimesh dhe ndërveprimesh të lidhura me momente të veçanta të zhvillimeve parazgjedhore. Vëmendja e audiencës duket se është ndikuar më shumë nga rëndësia dhe ndjeshmëria e ngjarjeve politike sesa vetëm nga sasia e përmbajtjes së publikuar.

Aktiviteti mediatike dhe ndërveprimi i publikut gjatë muajit qershor

Gjatë qershorit 2026, diskutimi publik u përqendrua kryesisht në zhvillimet që lidhen me zgjedhjet e 7 qershorit, rezultatet e tyre dhe deklaratat e grave politike të përfshira në debat. Të dhënat tregojnë një aktivitet të lartë mediatik në periudhën para dhe menjëherë pas zgjedhjeve, të pasuar nga një rënie e dukshme në pjesën e dytë të muajit.

Figura 3. Dinamika e artikujve, postimeve dhe ndërveprimeve publike gjatë muajit qershor 2026



Ndërveprimi i publikut shënoi rritjen më të madhe në fillim të muajit, duke arritur kulmin më 3 qershor me rreth 20,000 ndërveprime. Ky nivel i lartë, i regjistruar para ditës së zgjedhjeve, tregon interesimin e shtuar të audiencës për zhvillimet dhe deklaratat politike gjatë fazës përmblylëse të fushatës. Pas kësaj pike, ndërveprimet ranë gradualisht, ndonëse u shënuan disa rritje më të vogla gjatë pjesës tjetër të muajit.

Numri i artikujve arriti nivelin më të lartë më 9 qershor, dy ditë pas zgjedhjeve, me 461 artikuj të publikuar. Ky kulm përkon me periudhën e raportimit dhe komentimit të rezultateve zgjedhore. Nivele relativisht të larta të publikimit u regjistruan edhe gjatë ditëve para zgjedhjeve, veçanërisht më 3 dhe 6–8 qershor.

Pas valës kryesore të mbulimit zgjedhor, numri i artikujve ra ndjeshëm rreth mesit të muajit. Megjithatë, grafiku evidenton dy valë dytësore: të parën rreth 17–19 qershorit, me kulm prej afërsisht 300 artikujsh, dhe të dytën rreth 24–25 qershorit, me rreth 250 artikuj. Këto rritje sugjerojnë rikthimin e përkohshëm të vëmendjes mediatike ndaj

zhvillimeve paszgjedhore dhe reagimeve të aktorëve politikë. Nga fundi i muajit, aktiviteti mediatik ra ndjeshëm, përpara një rritjeje të lehtë më 30 qershor.


Postimet e drejtpërdrejta në rrjetet sociale mbetën përgjithësisht nën 70 postime në ditë dhe ndoqën pjesërisht dinamikën e artikujve. Ato ishin më të shpeshta në fillim të muajit dhe shënuan një rritje tjetër rreth 24–25 qershorit. Opinionet dhe shkrimet autoriale përbënin një pjesë minimale të përmbajtjes së përgjithshme gjatë gjithë periudhës.

Në tërësi, grafiku pasqyron një cikël të qartë zgjedhor të vëmendjes mediatike: ndërveprimi i publikut arriti kulmin përpara zgjedhjeve, ndërsa prodhimi i artikujve kulmoi menjëherë pas tyre. Kjo diferencë kohore sugjeron se publiku ishte më aktiv gjatë fazës së pritjes dhe debatit parazgjedhor, ndërsa mediat e intensifikuan raportimin pas votimit, me publikimin dhe interpretimin e rezultateve dhe të deklaratave politike. Megjithatë, lidhja ndërmjet këtyre kulmeve dhe temave konkrete duhet konfirmuar përmes analizës së përmbajtjes, pasi grafiku paraqet vëllimin e aktivitetit, por jo temat ose shkakun e secilës rritje.

Aktiviteti mediatike dhe ndërveprimi i publikut gjatë muajit korrik

Të dhënat e paraqitura për periudhën 1–24 korrik 2026 tregojnë një rënie të konsiderueshme të aktivitetit krahasuar me majin dhe qershorin, kur debati publik ishte i përqendruar te zgjedhjet. Numri ditor i artikujve nuk e tejkaloi nivelin prej rreth 250 publikimesh, ndërsa ndërveprimet arritën në pikën më të lartë afërsisht 6,800. Megjithatë intensiteti i përgjithshëm ishte më i ulët, aktiviteti u karakterizua nga disa rritje të shkurtra të lidhura me zhvillime të veçanta politike dhe tema me interes publik.

Figura 4. Dinamika e artikujve, postimeve dhe ndërveprimeve publike gjatë muajit korrik 2026



Numri i artikujve shënoi rritje graduale nga 6 deri më 10 korrik, duke arritur rreth 220 artikuj. Pas një rënieje të theksuar më 12 korrik, mbulimi mediatik u rrit përsëri dhe arriti

kulmin më 14 korrik, me 252 artikuj. Një valë tjetër u regjistrua më 17 korrik, me rreth 200 artikuj, ndërsa rritja e fundit e rëndësishme u shënuar më 21–22 korrik, me mbi 200 artikuj në ditë.

Ndërveprimi i publikut nuk ndoqi gjithmonë të njëjtën dinamikë me numrin e artikujve. Rritjet më të dukshme u regjistruan rreth 10 korrikut, me mbi 6,000 ndërveprime, më 15 korrik, kur u arrit kulmi i periudhës me afërsisht 6,800 ndërveprime, si dhe më 17 korrik, me mbi 6,000 ndërveprime. Këto kulme lidhen në kohë me mbulimin e deklaratës së Hykmete Bajramit për gjendjen në pediatri dhe me diskutimet rreth zgjedhjes së prokurorit nga presidentja në detyrë. Megjithatë, kontributi i saktë i secilës temë në rritjen e aktivitetit duhet të konfirmohet përmes analizës së përmbajtjes.

Diferenca kohore ndërmjet kulmit të artikujve më 14 korrik dhe kulmit të ndërveprimeve një ditë më vonë sugjeron se reagimi i audiencës mund të ketë vazhduar edhe pas publikimit fillestar të lajmeve. Ngjashëm, rritja e ndërveprimeve më 17 korrik ishte proporcionalisht më e lartë se vëllimi i artikujve, duke treguar se rëndësia ose ndjeshmëria e një teme mund të nxisë reagim të madh edhe pa një numër jashtëzakonisht të lartë publikimesh.


Postimet e drejtpërdrejta në rrjetet sociale mbetën përgjithësisht nën 50 në ditë. Rritjet e tyre kryesore u regjistruan rreth 14–15, 17 dhe 21–22 korrikut, duke ndjekur pjesërisht dinamikën e artikujve. Opinionet dhe shkrimet autoriale përfaqësuan një pjesë pothuajse të papërfillshme të përmbajtjes së monitoruar.

Në tërësi, periudha e monitoruar në korrik pasqyron kalimin nga një cikël intensiv zgjedhor drejt një agjende mediatike më të fragmentuar. Vëmendja nuk u përqendrua më në një proces të vetëm politik, por u aktivizua në valë të shkurtra rreth deklaratave dhe vendimeve të caktuara. Kjo tregon se, pas zgjedhjeve, ndërveprimi i publikut u ndikua më shumë nga ndjeshmëria e temave individuale sesa nga vëllimi i përgjithshëm i raportimit mediatik.

Rastet e dezinformimit dhe sulmeve me bazë gjinore ndaj grave politikane

Përmbajtjet e pavërteta dhe sensacionaliste për Vjosa Osmani-Sadriun

Monitorimi i realizuar përmes platformës Pikasa tregon se, gjatë periudhës 1–23 korrik 2026, faqja në Facebook Gazeta Diaspora publikoi 11 artikuj që kishin në fokus Vjosa Osmani-Sadriun. Përmbajtjet përdornin në mënyrë të përsëritur tituj sensacionalë dhe pretendime të pabazuara ose të pavërteta, me synim nxitjen e kureshtjes së përdoruesve dhe orientimin e tyre drejt uebsajtit *ballkantoday.com*.



3

Gazeta Diaspora [Q matches](#)

f  Opa – Vjosa Osmani kandidate per kryetare te LDK-se? Ky lajm do iu befasoje 🤔 Detajet e plota ketu: <https://trend.ballkantoday.com/en/opa-vjosa-osm...>

👍 46 eng. 🗨 19 📄 26 🔄 1 🕒 2 weeks ago 📎 74 📊 5,150



4

Gazeta Diaspora [Q matches](#)

f  LAJMI I FUNDIT: Vetëvendosje merr vendim për Vjosa Osmanin 🤔 Detajet e plota: <https://trend.ballkantoday.com/en/vetevendosje-merr-vendim-per-vjosa-...>

👍 39 eng. 🗨 26 📄 13 🔄 0 🕒 4 days ago 📎 46 📊 4,455



5

Gazeta Diaspora [Q matches](#)

f  Çka tha Vjosa Osmani qe i çuditi te gjithë 🤔 Lexojeni: <https://trend.ballkantoday.com/en/vjosa-osmani-me-nje-mesazh-qe-po-trazon-politiken-vdekj...>

👍 34 eng. 🗨 15 📄 18 🔄 1 🕒 2 weeks ago 📎 52 📊 4,047



6

Gazeta Diaspora [Q matches](#)

f  Nuk do ta besoni se çka tha Vjosa Osmani, lexojeni vet 🤔 Detaje: <https://trend.ballkantoday.com/en/votuesve-te-lvv-se-nuk-do-tju-pelqej-kjo-deklar...>

👍 30 eng. 🗨 18 📄 12 🔄 0 🕒 3 weeks ago 📎 62 📊 3,679



7

Gazeta Diaspora [Q matches](#)

f  VIDEO 📺 Gani Geci publikon videon që Vjosa Osmani nuk do të donte ta shihte kurrë: Ja çka thoshte kur... 🤔 Detajet e... [https://trend.ballkantoday.com/en/votuesve-te-lvv-se-nuk-do-tju-pelqej-kjo-deklar...](#)

👍 27 eng. 🗨 18 📄 7 🔄 2 🕒 one week ago 📎 67 📊 3,371

Postimet karakterizoheshin nga emoji alarmuese, pyetje provokuese dhe formulime që linin të kuptoheshin zhvillime të jashtëzakonshme pa ofruar informacion të verifikueshëm. Ndër to përfshiheshin pretendime për lëvizje të mundshme partiake, konflikte politike dhe "goditje të rënda". Këto elemente janë karakteristike për përmbajtjen *clickbait*, e cila synon të risë numrin e klikimeve dhe ndërveprimeve, potencialisht për përfitime financiare nga trafiku online. Si pasojë, kufiri ndërmjet raportimit informativ dhe përmbajtjes manipuluese bëhet më pak i dallueshëm për publikun.



Përmbajtjet e monitoruara shfaqin gjithashtu elemente të dezinformimit me bazë gjinore. Osmani-Sadriu paraqitet herë si e pafuqishme dhe e varur nga vendimet e aktorëve të tjerë politikë, e herë si e përfshirë në skandale personale apo në materiale të pretenduara si "të padëshiruara". Këto kornizime e zhvendosin vëmendjen nga veprimtaria dhe përgjegjësitë e saj institucionale drejt insinuatave që synojnë figurën dhe kredibilitetin personal.

Postimet e përfshira në monitorim arritën një audiencë prej mbi 20,000 përdoruesish dhe nxitën reagime, përfshirë komente fyese dhe gjuhë të urrejtjes. Shtrirja e tyre tregon se edhe një numër relativisht i vogël publikimesh mund të ketë ndikim të konsiderueshëm kur përmbajtja ndërtohet për të provokuar reagime emocionale dhe për t'u shpërndarë me shpejtësi.


Këto raste nënvizojnë nevojën për verifikim sistematik të pretendimeve, raportim të përmbajtjeve që shkelin standardet e platformave dhe bashkëpunim me organizatat e kontrollit të fakteve. Megjithatë, përcaktimi i motivit financiar ose politik dhe klasifikimi përfundimtar i secilit publikim si dezinformim kërkojnë verifikim të veçantë të përmbajtjes, burimit dhe qëllimit të publikuesit.

Dezinformimi dhe sulmet me bazë gjinore ndaj Fitore Pacolli-Dalipit

Monitorimi i përmbajtjeve për Fitore Pacolli-Dalipin evidenton një model të përsëritur sulmesh politike dhe gjinore, të mbështetur kryesisht në dy narrativa delegjitimuese.



Narrativa e parë e paraqet atë si “tradhtare kombëtare” përmes fotomontazheve, përdorimit të simboleve serbe dhe pretendimeve të pavërtetuara. Kjo mënyrë e paraqitjes ndërthur kundërshtimin politik me stigmatizimin etnik dhe nxit reagime që përmbajnë fyerje dhe gjuhë urrejtjeje me bazë etnike. Në këtë mënyrë, debati largohet nga qëndrimet ose përgjegjësitë konkrete politike dhe zhvendoset drejt sulmeve ndaj identitetit dhe përkatësisë së saj.



Narrativa e dytë synon ta lidhë figurën e saj me korrupsionin dhe nepotizmin politik. Për këtë qëllim instrumentalizohen komunikime ose ndërveprime private dhe përdoren nofka stigmatizuese, si “Tole ‘subvencion’ Pacolli”. Përsëritja e këtyre

etiketimeve synon të krijojë një lidhje automatike ndërmjet emrit të saj dhe aferave të pretenduara, edhe kur publikimet nuk paraqesin prova të mjaftueshme që i mbështesin akuzat.

Përveç delegjitimitit politik, komentet përmbajnë edhe sulme të drejtpërdrejta me bazë gjinore. Ato përfshijnë krahasime dehumanizuese, etiketime shtazëruese dhe fyerje që vënë në shënjestër moralin dhe dinjitetin e saj si grua. Terma të tillë nuk lidhen me punën apo qëndrimet e saj politike, por mbështeten në stereotipe patriarkale që synojnë turpërimin dhe përjashtimin e grave nga debati publik.

Përmbajtje të tilla mund të marrin shtrirje më të madhe kur burojnë nga deklaratat e figurave publike, ripublikohen nga mediat online ose shndërrohen në tituj *clickbait*. Ndërthurja e akuzave politike me fyerjet gjinore dhe etnike krijon një mjedis digjital armiqësor, i cili dëmton cilësinë e debatit publik dhe mund të dekurajojë pjesëmarrjen e grave në politikë.

Të dhënat tregojnë një model të koordinuar në nivel narrativ, por jo domosdoshmërisht një fushatë të orkestruar ndërmjet aktorëve të ndryshëm. Për të dëshmuar koordinim të organizuar do të nevojiteshin të dhëna shtesë për burimin, kohën e publikimeve, lidhjet ndërmjet faqeve dhe mënyrën e shpërndarjes së përmbajtjes.



Rekomandime

1

Të forcohen mekanizmat e llogaridhënies së mediave përmes promovimit të standardeve etike të raportimit dhe shmangies së amplifikimit të narrativave misojene dhe sulmeve të bazuara në gjini.

2

Të rriten kapacitetet e monitorimit dhe reagimit të institucioneve përkatëse, përfshirë organet rregullatore, organizatat për verifikimin e fakteve dhe organizatat e shoqërisë civile, me qëllim të identifikimit dhe adresimit më efektiv të dezinformatave me bazë gjinore.

3

Të avancohen programet e edukimit medial dhe digjital, për të ndihmuar qytetarët të identifikojnë përmbajtjet e manipuluar, stereotipet gjinore dhe fushatat dezinformuese që synojnë gratë në jetën publike.

4

Të inkurajohen partitë politike dhe institucionet publike që të miratojnë dhe zbatojnë kode të qarta të sjelljes, të cilat dënojnë gjuhën seksiste, ngacmimin online dhe sulmet me bazë gjinore nga zyrtarët publikë dhe përfaqësuesit politikë.

5

Të përmirësohet bashkëpunimi me platformat e rrjeteve sociale për të mundësuar raportim më të shpejtë dhe largim më efikas të përmbajtjeve që promovojnë gjuhën e urrejtjes, ngacmimin apo dezinformimin me bazë gjinore.

6

Të krijohen dhe forcohen mekanizmat mbështetës për gratë në jetën publike, duke përfshirë ndihmën juridike, mbështetjen psikologjike dhe trajnimet për sigurinë digjitale, me qëllim të zbutjes së ndikimit të abuzimit online.

7

Të promovohen narrativa pozitive dhe përfaqësimi i barabartë i grave në media dhe në diskursin publik, në mënyrë që të kundërshtohen stereotipet e dëmshme dhe të kontribuohet në krijimin e një mjedisi demokratik më gjithëpërfshirës dhe më të barabartë.

